



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Janar, 2021
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë
Përgatitur	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në Drejtorinë e Shëndetësisë

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes - ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit janar 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 389 lëndë të ndryshme, stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë për tu njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF, dhe njësitë e saja si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i Plan prokurimi 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Përgatitje:
 - Raport dhjetor DSH - 2020;
 - Raport vjetor DSH 2020;
 - KPSH- Granti specifik – MSH;
 - Postet drejtuese – të punësuarit në shërbimin civil;
 - Raporte përfundimtare – menaxhimi i kontratave 2020 – prokurim;
 - Raporti përfundimtar Plan prokurimi 2021 – DSH;
 - Plani i veprimit për infrastrukturë shëndetësore dhe sociale;
 - Përpilim të dhënash – Plani i Veprimit për Përmirësimin e Performancës (PVPP) 2021;
 - Përpilim të dhënash – Plani gjithëpërfshirës i komunave 2020 - Zyra për integritet evropiane;
 - Inventari aktual DSH;
- Inicimi i procedurave administrative rreth aplikimit për marrje leje të ndërtimit QMF Prishtina e Re – Zona Perëndim, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Kadastrës, KEDS, KRU “Prishtina” dhe ndërmarrja “Termokos”;
- Identifikim dhe përgatitja e specifikave për procedurë prokurimi shkurt 2021;
- Përpilim i specifikave;
 - Furnizim me material shpenzues laboratorik, stomatologjik dhe mjekësor;
 - Mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore laboratorike, stomatologjike dhe sterilizatorëve;
 - Dezinfektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës;
 - Deratizimi i rrjetit të kanalizimit, podrumëve dhe garazheve publike në Komunën e Prishtinës;
 - Digjitalizimi i shërbimeve laboratorike;
 - Furnizimi me material administrativ shëndetësor;
- Përcaktim i stafit mbikëqyrës;
 - Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së;
- Përcaktimi i ekipit vlerësues;
 - Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19;
- Ri negociim i kontratës – Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore e KPSH-së;
- Monitorim dhe mbarëvajtje e aktivitetit:
 - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të KPSH-së;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Finalizimi i punimeve dhe inventarizimi i hapësirës ku ofrohen shërbime radiologjike – QMF 5, digjitalizimi i shërbimeve radiologjike;

- Organizohet dhe mbahet procedura e rekrutimit bazuar në konkursin e hapur në 2020.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Përgatitje teknike rreth renovimit të objektit QMF 4;
- Përgatitja e specifikave bazuar në Plan prokurimin 2021;
- Mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar me buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuara, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese;

- Përgatitje e formularëve për regjistrim biznesesh;

- Raport javor, mujor dhjetor 2020;

-Përgatitja e dokumenteve te nevojshme për procedim te mëtutjeshëm.

5.1.2. Takimet me palë;

- Çdo dite nga ora 9:00 deri në ora 15:00 Drejtoria e Shëndetësisë bën pranimin e palëve.

5.1.3. Takimet me institucione tjera;

- Drejtoria e Investimeve Kapitale;
 - o Menaxhim i kontratës – Renovime dhe rindërtime;
- Drejtoria e Prokurimit;
 - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;

- Drejtoria e Urbanizmit:
 - o Kushte ndërtimore- Projekte arkitektonike QMF Prishtina e Re-Zona perëndim;
- Drejtoria e Pronës:
 - o Kopje plani dhe fletë poseduese QMF Prishtina e Re - Zona perëndim.

5.1.4. Diskutime publike, takime me qytetarë;

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;

- Drejtoria e Urbanizmit:
- Drejtoria e Pronës

5.1.6. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër;

- Të pranuar në DSH ishin 389 lëndë;

5.1.7. Përfitues të subvencioneve;

5.1.8. Takime të tjera.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;

- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
 - o tre Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 - 13:30; 13:30 - 19:00 dhe 19:00 - 07:00);
 - o katër qendrave të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) edhe gjatë janarit kanë punuar me orar të punës prej: 07:00 - 19:00, dhe kujdestari fundjave: 07:00 - 19:00 të shtunave dhe 07:00 - 13:00 të dielave;
 - o Në qendrat tjera (QMF 1, 3, 8, 9, 10, 11, Mat dhe Mat 1 si dhe AMF Bardhosh) është punuar në një ndërrim nga ora 08:00 - 16:00 si dhe në AMF Mramor, AMF Shkabaj dhe AMF Keqekollë (07:00 - 14:00);
- Numri i stafit të infektuar deri më 31 janar 2021 ka arritur shifrën prej 357 personave me së paku tre veta që për herë të dytë janë konfirmuar pozitiv;
- Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje kanë vazhduar të qëndrojnë ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve;
- QMF 7 në Emshir ka vazhduar të shërbejë si qendër për administrimin e terapisë parenterale për qytetarët e Prishtinës të infektuar me COVID 19 edhe gjatë muajit janar, në dy ndërrime 8 orëshe: 8:00 - 16:00 dhe 16:00 - 24:00;
- Gjatë muajit janar 2021 janë administruar plot 4443 infuzione intravenoze (2516 ose 81.2 brenda 8 orësh në ndërrimin e parë dhe 1927 gjatë ndërrimit të dytë ose 62.2 infuzione në ndërrim) me një mesatare prej rreth 143.3 infuzionesh për 16 orë me varirime prej 177 (me 1 janar) deri me 108 (25 janar 2021), dhe me një trend të uljes graduale;
- Prandaj, puna në QMF 7 ka vazhduar me kapacitet të rritur (gjithsejtë 23 shtretër) dhe potencial të shtuar resursesh humane;
- Ndërkohë në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit, që të dyja këto falas;

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paraditës, pasditës dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik ka vazhduar punën në të gjitha QMF-të me orar të rregullt dhe ka kthyer të gjitha shërbimet e veta në funksion.

REKOMANDIM

- Që nga 1 shkurti stafi infermieror i angazhuar në QMF 7 është zvogëluar për një infermiere;
 - o Me regrutimin e mjekëve të rijnë familjarë planifikohet që të kthehen në orarin me dy ndërrime (07:00-13:30 dhe 13:30 -19:00) edhe QMF 1, 11, Mat dhe Mat 1 me qëllim të mbulimit më të lehtë edhe të kujdestarive të fundjavës;
 - o Të kthehen në funksion edhe dy AMF (Llukar dhe Barilevë).

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente – Prishtinë, gjatë muajit janar 2021, vazhdoj punën duke ju përshtatur situatës epidemiologjike për ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente për të gjithë banorët e Prishtinës dhe fshatrave.

Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet e mëposhtme urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve:

- Hipertension arterial;
- Sëmundjet kronike obstructive të mushkërive;
- Astma bronchiale;
- Gjendjet febrile të dyshimta për COVID – 19;
- Abdomeni akut;
- Ataqet cerebrovaskulare;
- Colicat renale acute;
- Syndromi akut koronar;
- Syndromi post traumatic;
- Syndroma cervicobrachiale;
- Rheumatoid artriti ;
- Aksidentet e trafikut etj.

Ekipi mjekësor nga Qendra e Mjekësisë Urgjente gjatë muajit janar asistoj;

- Me datë 31. janar. 2021 ndeshjen e kupës së qyteteve të Kosovës ndërmjet Prishtinës dhe Podujevës.

1	Vizita mjekësorë urgjente në terren	1325
	Vizita mjekësorë të tjera	34
2	Vizita mjekësorë në QMU	0
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	5
4	Shërbimi i rea. në terren	1
	Shërbimi i rea. në QMU	0
5	Observim (intenziv)	0
6	Shërbimi i infermierisë	2

7	Aksidentet	77
8	Fatkeqësitë në punë	0
	Fatkeqësi të tjera	77
9	Shërbimi laboratorik	0
10	EKG	24
11	Transportet	216
12	Konstatim vdekjeje	58
	Gjithësej	1819